



Inventory of Banking Supervision framework

Please send your contributions no later than Friday, September 5th, 2008

Regulatory framework		To be revised Yes / No
Regulations		
<i>1- Substantial changes - High Priority regulations</i>		
1	<p>Regulation “On Credit risk administration”</p> <p>Rregullore “Për administrimin e rrezikut të kredisë</p> <p>Qëllimi - Neni 2</p> <p>Qëllimi i kësaj rregulloreje është administrimi i rrezikut të kredisë në mënyrë që banka të minimizojë humbjet e mundshme nga kreditë dhe nga aktivet e tjera te ngjashme me to dhe te ndjeshme ndaj levizjeve te normave te interesit (me poshte, aktive te tjera).</p> <p>Në këtë rregullore përcaktohen kriteret, kategoritë dhe metodat e klasifikimit të kredive dhe të aktiveve të tjera të bankës, duke llogaritur një nivel të përshtatshëm fondesh rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga pamundësia e rekuperimit të vlerës së plotë të tyre.</p> <p>Për nevojat e kësaj rregulloreje, me rrezik të kredisë kuptohet pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit të kredisë ose e kundërpartisë për aktivet e tjera, për të përmbushur detyrimet ndaj bankës sipas kushteve të marrëveshjes të lidhur mes tyre.</p> <p>Komente:</p>	
2	<p>Regulation “On capital adequacy”</p> <p>Rregullore “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”</p> <p>Kapitulli I</p> <p>3. Qëllimi i kësaj rregulloreje është llogaritja e raportit ndërmjet kapitalit rregullator me aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rreziqet që quhet “Raporti i</p>	

	To be revised Yes / No
<p style="text-align: center;">Regulatory framework</p> <p>mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe vendosja e një kufiri minimal të raportit që quhet “Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit”.</p> <p>Komente: Kapitulli I – Te pergjithshme Kapitulli II – Elemente perberese</p>	
<p>3 Regulation “On foreign exchanges’ open position”</p> <p>Rregullore "Për pozicionet e hapura valutore"</p>	
<p>1. Të përgjithshme 2. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit maksimal të pozicioneve të hapura valutore neto për subjekte të tilla si banka dhe degë të bankave të huaja, të cilat janë licencuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer veprimtari bankare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto subjekte, për efekt të kësaj rregulloreje do të quhen “bankë”.</p> <p>Komente:</p>	
<p>4 Directive “On banks’ regulatory capital”</p> <p>Udhëzim "Për kapitalin rregullator të bankës"</p>	
<p>Chapter I - General 3. The purpose of this Guideline is to define the calculation method of Regulatory Capital of banks in order to cover credit risk.</p> <p>Komente: Kapitulli I – Te pergjithshme Kapitulli II – Kapitali rregullator per mbulimin e rrezikut te kredise</p>	

Regulatory framework		To be revised Yes / No
5	<p>Regulation “On the amount and fill in the “initial minimal capital” on allowed activities for banks and foreign branches”.</p> <p>Rregullore "Për madhësinë dhe plotësimin e "kapitalit fillestar minimal" për veprimtaritë e lejuara për bankat e degët e bankave të huaja të licencuara"</p> <p>Neni 3. Qëllimi i saj është plotësimi i “kapitalit fillestar minimal” nga bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara përpara publikimit nga Banka e Shqipërisë të ndryshimit të kapitalit fillestar minimal dhe përcaktimit të madhësisë të kapitalit për bankat dhe degët e bankave të huaja që kërkojnë të ushtrojnë veprimtaritë financiare, në përputhje me pikën 4 dhe me pikën 5 të nenit 26, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” .</p> <p>Komente:</p>	
6	<p>Bank Accounting Manual Issued in 1999, with the support of Ernst and Young</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>Pjesa 1: Lista e llogarive dhe parimet e përgjithshme Pjesa 1.1 : Plani i llogarive Pjesa 1.2 : Parimet e përgjithshme kontabël dhe dokumentacioni kontabël</p> <p>Pjesa 2 : Skemat kontabël Pjesa 2.1: Paraqitja e veprimeve bazë bankare Pjesa 2.2: Paraqitja e regjistrimeve bazë kontabël</p> <p>Pjesa 3 : Raportet financiare Pjesa 3.1: Raportet financiare vjetore Pjesa 3.2: Raportet financiare periodike</p> <p>Komente:</p>	
<i>2 - Light Changes Technical Regulations – Second Priority</i>	
<p>1 High Priority regulations Regulation “On administering bank’s large exposure risks”</p> <p>Rregullorja "Për administrimin e rezikut nga ekspozimet e mëdha të Bankave"</p>	
<p>Kreu I - Dispozita të përgjithshme</p> <p>Neni 1 - Objekti Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe kritereve për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur ndërmjet tyre ose me bankën, për qëllim të administrimit të rezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre.</p> <p>Komente:</p> <p>Kreu I - Dispozita të përgjithshme</p>	

	To be revised Yes / No
<p style="text-align: center;">Regulatory framework</p> <p>Kreu II - Llogaritja e ekspozimit të madh</p> <p>Kreu III - Mbikëqyrja dhe raportimi</p>	
<p>2</p> <p>Regulation “On Credit Bureau in the Republic of Albania”</p> <p>Rregullore "Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë"</p>	
<p>Kreu I - Dispozita Të Përgjithshme</p> <p>Neni 1 - Qëllimi Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë.</p> <p>Komente: Kreu I - Dispozita Të Përgjithshme</p> <p>Kreu II - Raportimi I Informacionit dhe i të Dhënave që Mbahen në Regjistrin e Kredive</p> <p>Kreu III - Mënyra dhe Kushtet E Përdorimit Të Informacionit dhe Të Të Dhënave Të Regjistrit Të Kredive</p> <p>Kreu IV - Dispozita Përfundimtare</p>	
<p>3</p> <p>Regulation “On risk administration in the foreign bank branches activities”</p> <p>Rregullore “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja”</p>	
<p>Kreu I - Të përgjithshme</p> <p>Neni 1 - Objekti Objekti i kësaj rregulloreje është:</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>a. përcaktimi i instrumenteve që sigurojnë ushtrimin në mënyrë të sigurtë dhe të qëndrueshme të veprimtarisë së degës së bankës së huaj;</p> <p>b. vendosja e kufizimeve maksimale të ekspozimit ndaj disa prej rreziqeve në ushtrimin e veprimtarisë së degës së bankës së huaj;</p> <p>c. përcaktimi i kërkesave dhe i detyrimeve mbi raportimet dhe dokumentacionin verifikues për zbatimin e kësaj rregulloreje.</p> <p>Komente:</p> <p>Kreu I - Të përgjithshme</p> <p>Kreu II - Instrumentet e administrimit të rrezikut</p> <p>Kreu III - Ekspozimi ndaj rreziqeve</p> <p>Kreu IV - Mbikëqyrja dhe raportimi</p> <p>Kreu V - Dispozita përfundimtare</p>	
<p>4 Regulation on the Consolidated supervision.</p> <p>Rregullore për mbikëqyrjen e konsoliduar</p>	
<p>Neni 3 Qëllimi i mbikëqyrjes së konsoliduar Mbikëqyrja e konsoliduar vlerëson pozicionin ndaj rrezikut/rreziqeve jo vetëm të veprimtarisë së vet shoqërisë, por edhe të veprimtarisë së filialeve dhe të pjesëmarrjeve të saj.</p> <p>Komente:</p>	
<p>5 Regulation “On bank’s investments on commercial companies’ capital”</p> <p>Rregullore "Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare"</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>Neni 2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit ndërmjet aktivitetit të lirë të investimit të bankave në kapitalin e shoqërive tregtare dhe respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse.</p> <p>Komente:</p>	
<p>6 Methodical directive “On foreign exchange risks”</p> <p>Udhëzim metodik "Për rreziqet nga këmbimet valutore"</p> <p>I. Koncepti I Rreziqeve Nga Pozicionet e Hapura Nga Këmbimet Valutore II. Mënyrat E Administrimit Të Rreziqeve Nga Këmbimet Valutore. III. Raportimet Për Pozicionet e Hapura. IV. Rivlerësimi dhe Pasqyrimi Kontabël.</p> <p>Komente:</p>	
<p>7 Directive “On interest rate risk administration”</p> <p>Udhëzim "Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit"</p> <p>Kreu I - Të Përgjithshme</p> <p>1.3 Qëllimi i këtij udhëzimi është dhënia e rekomandimeve lidhur me administrimin e rrezikut, që vjen si rezultat i pozicionit të bankës në letrat me vlerë, në instrumentet e portofolit të tregtueshëm dhe të lëvizjes së normës së interesit si edhe vlerësimi nga bankat imjaftueshmërisë dhe i efektivitetit të administrimit të rrezikut të normës së interesit.</p> <p>Komente:</p> <p>Kreu I - Të Përgjithshme</p> <p>Kreu II - Elementet Bazë Të Administrimit Të Rrezikut Të Normës Së Interesit</p>	

Regulatory framework		To be revised Yes / No
<i>3 - No changes</i>		
1	<p>Regulation “On internal control systems of banks and foreign branches”</p> <p>Rregullore "Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Bankat dhe Degët e Bankave të Huaja"</p> <p>Kapitulli I - Të Përgjithshme 2. Qëllimi i këtij udhëzimi është krijimi i një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm si një faktor kryesor në drejtimin dhe në administrimin e bankave.</p> <p>Komente: Kapitulli I - Të Përgjithshme</p> <p>Kapitulli II - Realizimi I Kontrollit Të Brendshëm</p> <p>Kapitulli III - Llojet E Kontrolleve Të Brendshme</p> <p>Kapitulli IV - Të Tjera</p>	
2	<p>Regulation “On the use of information and communication technology on the subjects licensed by BoA”.</p> <p>Rregullore "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë"</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>Article 2 - Scope</p> <p>(1) This regulation shall establish the criteria and conditions that the entities of this regulation have to complete on the organisation and functioning of their Information and Communication Technology systems (following referred as ICT).</p> <p>(2) The definition of these criteria and conditions on the organisation and functioning of ICT systems and their implementation, aims to reduce the operational risk that might be arose from the misuse of ICT systems, and to provide the reliability of these systems in supporting the activity of these entities.</p> <p>Komente:</p>	
<p>3 Regulation “On anti- money laundering”</p> <p>Rregullore "Për parandalimin e pastrimit të parave"</p> <p>Neni 3 Ky udhëzim shërben për hartimin e politikave dhe të procedurave të bankave dhe për krijimin e kushteve për zbatimin e tyre, lidhur me parandalimin e pastrimit të parave.</p> <p>Komente:</p> <p>II. Procedurat e Identifikimit dhe të Raportimit III. Strukturat Përkatëse Bankare dhe Përgjegjësitë</p>	
<p>4 Regulation “On administrators of banks and foreign branches”</p> <p>Rregullore "Për administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja"</p> <p>Neni 1 - Dispozita Të Përgjithshme Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizmin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e bankës</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.</p> <p>Komente:</p>	
<p>5 Regulation “On foreign exchange activity”</p> <p>Rregullore "Për veprimtarinë valutore"</p> <p>Kreu I - Dispozita Të Përgjithshme</p> <p>1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e rregullave lidhur me veprimet në llogarinë kapitale dhe në llogarinë korente, midis rezidentëve dhe jorezidentëve, nga brenda-jashtë dhe nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Komente:</p> <p>Kreu II - Veprimet Valutore Kreu III - Transferimi I Kapitalit Kreu IV - Investimet Dhe Llogaritë E Jorezidentëve Kreu V - Detyrimi Për Raportim Kreu VI - Lëvizjet Fizike Të Valutës, Të Arit dhe Të Metaleve Të Çmuara Kreu VII - Dispozita Të Fundit</p>	
<p>6 Regulation “On statutory auditor / external authorized auditors”</p> <p>Rregullore "Për ekspertët kontabël të autorizuar"</p> <p>Neni 1 - Dispozita të përgjithshme Në këtë rregullore përcaktohen :</p> <ul style="list-style-type: none"> • kriteret dhe procedurat për miratimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të emëruar nga bankat; • fusha e veprimtarisë, forma dhe përmbajtja e kontrollit dhe e raporteve të kontrollit të bankës nga ekspertët kontabël të autorizuar. 	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>1.4 Për efekt të kësaj rregulloreje “kontrolli i ushtruar nga eksperti kontabël i autorizuar “ përfshin :</p> <p>a - kontrollin e raporteve bazë financiare, që në vijim quhen “raporte financiare” qëpërgatiten nga banka në përputhje me “Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit(IASs)” përveç kur është parashikuar ndryshe në ligjin “Për kontabilitetin” dhe në“Manualin e kontabilitetit bankar”. Raportet bazë financiare përgatiten për botim dheshërbejnë për përdorim të përgjithshëm;</p> <p>b- vlerësimin e pasqyrave financiare me karakter specifik të përgatitura nga banka në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;</p> <p>c- vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë të akteve nënligjore dhe të procedurave të bankës, dhe zbatimin e tyre.</p> <p>Komente:</p>	
<p>7 Regulation “On market risk”</p> <p>Rregullore "Mbi rreziqet e tregut"</p> <p>Kapitulli I - Të Përgjithshme</p> <p>Subjekte të analizës së rreziqeve të tregut janë të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat për efekt të kësaj rregulloreje në vazhdim do të quhen “bankë”, që plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:</p> <p>2.1. Vlera kontabile e letrave me vlerë të portofolit të tregtueshëm është mesatarisht më e madhe se 5 për qind e shumës të totalit të aktivitetit dhe të totalit të jashtë-bilancit gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit ose më e madhe, në çdo kohë, se 6 për qind e shumës të totalit të aktivitetit dhe të totalit të jashtë-bilancit;</p> <p>2.2. Totali i letrave me vlerë të portofolit të tregtueshëm është mesatarisht më i madh se 15 milionë euro gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit ose më i madh në çdo kohë se 20 milionë euro.</p> <p>Qëllimi i kësaj rregulloreje është llogaritja e kërkesës për kapitalin rregullator për mbulimin e rreziqeve të tregut. Me rrezik të tregut kuptojmë rrezikun e humbjes në pozicionin në bilanc dhe jashtë-bilancit si rezultat i ndryshimeve të çmimeve në tregun financiar. Ai ka të bëjë me analizën e rrezikut të pozicionit:</p> <p>3.1. të normës të interesit për letra me vlerë me të ardhura fikse;</p> <p>3.2. të çmimit të tregut të letrave me vlerë me të ardhura variabël;</p> <p>3.3. të rregullimeve të shlyerjes me kundërpartinë;</p> <p>3.4. të tejkalimeve të kufijve për rreziqet e mëdha;</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>3.5. të këmbimeve në valutë.</p> <p>Komente:</p> <p>Kapitulli II - Kapitali Rregullator për Mbulimin e Rreziqeve Të Tregut</p> <p>Kapitulli III - Përcaktimi I Pozicionit Neto</p> <p>Kapitulli IV - Rreziku nga Normat e Interesit</p> <p>Kapitulli V - Rreziku nga Këmbimet Në Valutë</p>	
<p>8 Regulation “On Cooperative banks”</p> <p>Rregullore "Për bankat kooperativë"</p> <p>Neni 1 - Të përgjithshme</p> <p>1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve të krijimit, të ushtrimit të aktivitetit, të licencimit dhe të mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë të bankave kooperativë, si dhe veçoritëe këtyre bankave.</p> <p>Komente:</p> <p>Kapitulli I - Krijimi dhe Aktiviteti</p> <p>Kapitulli II - Licencimi</p>	
<p>9 Directive “On foreign exchange reports”</p> <p>Udhëzim "Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore"</p> <p>Komente:</p>	
<p>10 Directive “On bank’s custody and liquidation”</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>Udhëzim "Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave"</p> <p>Dispozita të përgjithshme</p> <p>2. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat, procedurat dhe detyrimet e palëve kur njëbankë merret në administrim të përkohshëm nga Banka e Shqipërisë, vendoset në kujdestaridhe kur një bankë likuideohet.</p> <p>Komente:</p> <p>II. Kujdestaria III. Likuidimi IV. Administrimi i përkohshëm</p>	
<p>11 Directive “On Deposit Certificates”</p> <p>Udhëzim "Për çertifikatat e depozitave"</p> <p>Komente: Kapitulli i Parë - Të Përgjithshme</p> <p>Kapitulli i Dytë - Kontabiliteti I Çertifikatave Të Depozitave</p>	
<p>12 Directive “On bank’s liquidities”</p> <p>Udhëzim "Për likuiditetin e bankave"</p> <p>Neni 2</p> <p>1. Brenda sistemit të saj të informacionit, banka klasifikon aktivet, pasivet dhe zërat jashtë bilancit në përputhje me:</p> <p>a) datën e maturimit të aktiveve, të pasiveve dhe të zërave jashtë bilancit me afate fikse;</p> <p>b) zhvillimin e parashikuar të pasiveve me afate fikse në lidhje me vëllimin e mundshëm të depozitave të rivendosura nga kreditorët në datën e maturimit;</p> <p>c) eksperiencën e sjelljes së depozituesit në lidhje me depozitat pa afat dhe depozitat me afat sipas kushteve specifike;</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>d) shkallën e likuiditetit të aktiveve lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. disponueshmërinë e menjëhershme të tyre për të mbuluar daljen e fondeve, ii. mundësinë e kthimit të tyre në cash nga Banka e Shqipërisë, iii. tregtueshmërinë e tyre në tregun financiar, madhësia e të cilit do të lejojë shitjen e sasisë së kërkuar të aktiveve me një çmim, i cili korrespondon me vlerën tyre të tregut, ose me një çmim më të lartë ose të barabartë me vlerën e tyre kontabile, iv. rënien e mundshme të vlerës së aktiveve në të njëjtën masë me rënien e pasiveve përkatëse; <p>e) shumën e depozitës të një depozituesi ose të një grupi depozituesish të lidhur (si në pikën 2 më poshtë);</p> <p>f) tipin dhe shkallën e detyrimeve të zërave jashtë bilancit të dhëna dhe të marra nga banka;</p> <p>g) monedhat në të cilat aktivet, pasivet dhe zërat jashtë bilancit shprehen: Lekë, monedha të konvertueshme dhe monedha të pakonvertueshme.</p> <p>Komente:</p>	
<p>13 Directive “On the procedures for extracting the report on borrowers and on the revision of the information stored on the Credit Register”</p> <p>Udhëzimi “Për procedurën e nxjerrjes së raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive”</p> <p>Kreu I - Dispozita Të Përgjithshme Neni 1 - Qëllimi Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë procedurën për nxjerrjen e raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive.</p> <p>Komente:</p>	
<p>14 Manual on the corrective actions toward banks and foreign branches in the Republic of Albania.</p> <p>Manuali i veprimeve korrigjuese ndaj bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë</p> <p>Komente:</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No
<p>15 Regulation on The Relation between the bank and other persons connected to it.</p> <p>Rregullore për Marrëdhëniet e Bankës me Personat e Lidhur me Të.</p> <p>BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI - Neni 1</p> <p>1.2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve të bankës dhe degës së bankës së huaj me personat e lidhur me to.</p> <p>PËRCAKTIMET - Neni 2</p> <p>2.1. Me persona të lidhur kuptojmë dy ose më shumë individë dhe/ose persona fizikë dhe/ose persona juridikë, të cilët mund të jenë rezidentë ose jorezidentë në Republikën e Shqipërisë, që për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje:</p> <p>2.1.1. Plotësojnë kuptimin e termave të nenit 2, gërma f dhe gërma k, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.98 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, kur personi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës ose në kapitalin e një shoqërie tjetër e cila është aksionere e bankës, - ndikon në vendimmarrjen e bankës apo të shoqërisë tjetër aksionere të bankës, - është zotërues direkt ose indirekt i një pjese të kapitalit që i jep atij 25 për qind ose më shumë të votave të organit më të lartë vendimmarrës të bankës apo të personit tjetër juridik, - i vetëm ka në dispozicion shumicën e votave në bankë apo tek personi tjetër juridik, në bazë të një marrëveshjeje të përfunduar me ortakët ose me aksionerët e tjerë, - përcakton <i>de facto</i> nëpërmjet të drejtës së votës që zotëron, vendimet e marra në mbledhjet e organit më të lartë të bankës apo të personit tjetër juridik, përfshirë dhe zgjedhjen dhe emërimin e administratorëve të bankës. <p>2.1.2. Janë administratorë të bankës në përputhje me përcaktimet e bëra në rregulloren “Për administratorë të bankës dhe të degës së bankës së huaj” dhe familjarët e tyre.</p> <p>Komente:</p>	

Regulatory framework	To be revised Yes / No